**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK, BORDI I ADMINISTRIMIT**

**Nr.2691 prot** **Korçë, më 17 / 12 / 2025**

**VENDIM**

**Nr. 759 , datë 17.12.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË MËSIMORE DHE KËRKIMORE-SHKENCORE TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, "Funksionet e Senatit Akademik", pika 1, gërma g, si dhe neni 49, "Funksionet e Bordit të Administrimit në Institucionet e arsimit të lartë", pika 1, gërma h, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, pasi diskutuan mbi raportin vjetor të veprimtarisë të institucionit për vitin akademik 2024-2025, të hartuar nga Rektorati i Universitetit si dhe duke u bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr 5, datë 19.02.2018, "Për përcaktimin e elementëve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", pika 4, në mbledhjen e përbashkët të datës 17.12.2025,

**VENDOSËN:**

1. Të miratojnë raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të vitit akademik 2024-2025, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

**KRYETARI I BORDIT**
**Alketa Zallëmi**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr.2560 prot** **Korçë, më 27 / 11 / 2025**

**VENDIM**

**Nr. 725 , datë 27.11.2025**

**PËR**
**MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK PËR ARSIMIN DIGJITAL GJITHËPËRFSHIRËS 2026-2029**

Në mbështetje të nenit 37, pika 1 të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", dhe nenit 17, pika 1 të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, me qëllim zhvillimin akademik dhe institucional të Universitetit "Fan S. Noli", në fushën e arsimit digjital, përfshirjes dhe modernizimit pedagogjik, Senati Akademik, në mbledhjen online të datës 27.11.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë "Planin Strategjik për Arsimin Digjital Gjithëpërfshirës 2026-2029", sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "FAN S . NOLI"**

# PLANI STRATEGJIK I ARSIMIT DIGJITAL GJITHËPËRFSHIRËS - UNKO

# 2026-2029

**Miratuar me Vendimin nr. 725, datë 27.11.2025 të Senatit Akademik të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë**

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**REKTORI**

**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

**Plani Strategjik për Arsimin Digjital Gjithëpërfshirës në Universitetin "Fan S. Noli" 2026–2029**
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, Dhjetor 2025

Ky dokument është hartuar me mbështetjen e projektit ***HAWKING – Harvesting (digital) Alternation in Ways that Knock-down Inaccessibility of New Generations***, të financuar nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian.

**PËRMBAJTJA**

**HYRJE** ......................................................................................... **4**

**PLANI PËR ARSIMIN DIGJITAL GJITHËPËRFSHIRËS** ...................... **5**

**VIZIONI DHE MISIONI** ................................................................ **6**

**OBJEKTIVAT STRATEGJIKË** ......................................................... **9**

**MEKANIZMAT E ZBATIMIT DHE MONITORIMIT** ............................ **10**

**ANGAZHIMI PËR ZBATIM DHE PËRMIRËSIM TË VAZHDUESHËM** ... **21**

# I. HYRJE

Shkencat, arsimi dhe teknologjia po pësojnë transformime të shpejta që ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si mësojmë, komunikojmë dhe ndërveprojmë në jetën akademike. Arsimi i lartë, si sektor që gjeneron njohuri dhe formon kapitalin njerëzor të së ardhmes, është në qendër të këtij transformimi. Përfshirja digjitale është bërë një domosdoshmëri për zhvillimin institucional, për rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe për sigurimin e barazisë në aksesin ndaj njohurisë. Kjo kërkon një qasje të planifikuar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme që përfshin të gjitha hallkat e procesit arsimor dhe administrativ.

Në këtë kuadër, Universiteti "Fan S. Noli" i Korçës e konsideron arsimin digjital gjithëpërfshirës si pjesë të pandashme të misionit të vet akademik dhe shoqëror. Përmes këtij plani, universiteti synon të zhvillojë një mjedis arsimor ku çdo student dhe anëtar i stafit të ketë mundësi të barabarta për të përfituar nga përparësitë e teknologjisë, pavarësisht aftësive individuale, gjinisë, prejardhjes kulturore apo kushteve ekonomike. Përfshirja digjitale kuptohet si një proces i vazhdueshëm që kërkon ndërgjegjësim institucional, zhvillim të kapaciteteve njerëzore dhe optimizim të burimeve ekzistuese për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe të kërkimit shkencor.

Ndërhyrjet digjitale në universitet nuk kanë vetëm karakter teknik, por edhe kulturor e shoqëror. Ato prekin mënyrën e mendimit pedagogjik, komunikimin akademik dhe raportin mes mësuesit dhe studentit. Kjo e bën të domosdoshme ndërtimin e një kuadri strategjik që përfshin të gjitha dimensionet e përfshirjes dhe që synon zhvillimin e një kulture të re të të nxënit dhe mësimdhënies. Përmes këtij dokumenti, Universiteti "Fan S. Noli" synon të kalojë nga përdorimi sporadik i teknologjisë drejt një transformimi institucional të bazuar në parimet e Dizajnit Universal për të Nxënë (UDL) dhe në standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë digjitale.

Hartimi i Planit Strategjik për Arsimin Digjital Gjithëpërfshirës është rezultat i nevojës për të orientuar zhvillimin e universitetit drejt praktikave bashkëkohore evropiane, duke ruajtur njëkohësisht përmasën humane dhe sociale të arsimit publik. Ky dokument reflekton angazhimin e UNKO-së për të përmbushur objektivat e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026, të Planit të Veprimit të Bashkimit Evropian për Transformimin Digjital në Arsim dhe Trajnim 2021–2027, si dhe të rekomandimeve të nismave ndërkombëtare në fushën e arsimit të lartë dhe përfshirjes digjitale. Ai gjithashtu lidhet drejtpërdrejt me përvojat e fituara nga universiteti në kuadër të projekteve Erasmus+, përfshirë projektet që promovojnë aksesin në arsimin e lartë për studentët nga zona rurale dhe për personat me aftësi të kufizuara.

Nëpërmjet këtij plani, universiteti përcakton drejtimet strategjike për ndërtimin e një mjedisi digjital gjithëpërfshirës, ku teknologjia nuk shihet si qëllim më vete, por si mjet për të nxitur pjesëmarrjen, cilësinë dhe inovacionin në arsimin e lartë. Dokumenti synon të shërbejë si udhërrëfyes për të gjitha njësitë e universitetit në procesin e planifikimit dhe zbatimit të politikave të digjitalizimit, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet strukturave akademike, administrative dhe komunitetit studentor.

Në thelb, plani nuk synon vetëm modernizimin teknologjik të universitetit, por krijimin e një kulture institucionale të përfshirjes dhe barazisë, ku çdo anëtar i komunitetit universitar të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për të kontribuar dhe për t'u zhvilluar profesionalisht në një mjedis të hapur, të aksesueshëm dhe të drejtë.

## II. PLANI PËR ARSIMIN DIGJITAL GJITHËPËRFSHIRËS

Plani për Arsimin Digjital Gjithëpërfshirës i Universitetit "Fan S. Noli" është konceptuar si një strategji institucionale afatmesme që synon të garantojë qasje të barabartë në arsimin e lartë përmes përdorimit të teknologjive digjitale, të hapura dhe të aksesueshme. Ai mbështetet në parimin se transformimi digjital nuk duhet të krijojë ndarje të reja, por të reduktojë pabarazitë ekzistuese dhe të nxisë përfshirjen e plotë të çdo studenti dhe anëtari të stafit akademik e administrativ në jetën universitare.

Qasja e përfshirë në këtë plan nuk kufizohet vetëm në aspektin teknik të pajisjeve dhe platformave digjitale, por shtrihet në fushën pedagogjike, organizative dhe sociale të universitetit. Ajo synon të ndërtojë një mjedis gjithëpërfshirës të të nxënit, ku çdo individ të ketë mundësi të përdorë teknologjinë në mënyrë të pavarur dhe efektive. Përfshirja nënkupton përshtatjen e mësimdhënies dhe komunikimit akademik me nevojat dhe aftësitë e ndryshme të studentëve, duke respektuar diversitetin dhe duke eliminuar barrierat që kufizojnë pjesëmarrjen. Kjo qasje përputhet me filozofinë e Dizajnit Universal për të Nxënë (UDL), i cili promovon larmi mënyrash në prezantimin e informacionit, në angazhimin e studentëve dhe në mënyrat e shprehjes së dijes.

Në nivel institucional, plani synon të krijojë një arkitekturë të integruar për përfshirjen digjitale, që përfshin rishikimin e politikave të brendshme, zhvillimin e kapaciteteve të stafit dhe studentëve, përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe ndërtimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm. Kjo nënkupton që çdo strukturë e universitetit, nga Rektorati deri te njësitë kryesore, të ketë rol aktiv në zbatimin e planit, në përputhje me kompetencat përkatëse dhe me burimet e disponueshme.

Një element thelbësor i planit është përdorshmëria universale e shërbimeve digjitale, që përfshin jo vetëm qasjen në platforma dhe sisteme, por edhe aftësinë për t'i përdorur ato në mënyrë efektive. Kjo kërkon trajnim të vazhdueshëm të stafit akademik dhe teknik, përmirësim të ndërveprimit midis përdoruesve dhe sistemeve, si dhe garantimin që çdo përmbajtje e krijuar apo shpërndarë nga universiteti të jetë e përputhshme me standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë, si Udhëzimet për Aksesueshmërinë e Përmbajtjeve në Ueb (WCAG 2.1). Përmes kësaj qasjeje, UNKO synon të sigurojë që mjedisi i tij digjital të jetë i hapur, i qëndrueshëm dhe i ndjeshëm ndaj nevojave të të gjithë përdoruesve.

Plani për arsimin digjital gjithëpërfshirës ndërtohet mbi parimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave akademike dhe mbështetëse të universitetit, studentëve dhe partnerëve të jashtëm. Ai synon të krijojë ura lidhëse midis arsimit, tregut të punës dhe shoqërisë përmes teknologjisë, duke e kthyer universitetin në një qendër që

promovon inovacionin, përfshirjen dhe barazinë sociale nëpërmjet arsimit digjital. Ky proces nuk është një ndërhyrje e përkohshme, por një transformim i vazhdueshëm institucional që forcon rolin e universitetit si aktor zhvillimi rajonal dhe si model i përfshirjes në arsimin e lartë shqiptar.

Në përputhje me dokumentet strategjike kombëtare dhe evropiane, plani është në linjë me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, e cila thekson nevojën për zhvillimin e kompetencave digjitale dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes inovacionit teknologjik. Ai harmonizohet gjithashtu me Planin e Veprimit të Bashkimit Evropian për Arsimin Digjital 2021-2027, që kërkon rritjen e përfshirjes, të barazisë në mundësi dhe të qasjes në mësimin online për të gjithë qytetarët. Për më tepër, plani merr në konsideratë udhëzimet e Komisionit Evropian për Aksesueshmërinë Digjitale (Digital Accessibility Guidelines) dhe synon t'i zbatojë ato në kontekstin shqiptar, në mënyrë që Universiteti "Fan S. Noli" të përmbushë standardet ndërkombëtare të transparencës, llogaridhënies dhe gjithëpërfshirjes.

Në këtë mënyrë, plani nuk është vetëm një dokument drejtues i brendshëm, por një instrument që vendos UNKO-n në rrugën e konvergjencës me sistemin evropian të arsimit të lartë, duke krijuar kushte reale për përmirësimin e cilësisë së përvojës studentore, për profesionalizimin e stafit akademik dhe për rritjen e impaktit shoqëror të universitetit në rajon.

## III. VIZIONI DHE MISIONI

### Misioni

Misioni i Universitetit "Fan S. Noli" në fushën e arsimit digjital gjithëpërfshirës është të sigurojë kushte të barabarta për të mësuar, për të kërkuar dhe për të krijuar njohuri, duke përdorur teknologjinë si mjet që fuqizon secilin individ dhe që lehtëson pjesëmarrjen e plotë të studentëve dhe stafit në jetën akademike. Universiteti synon të garantojë që çdo anëtar i komunitetit të tij të ketë qasje të drejtë, të lirë dhe të sigurt në mjetet digjitale, në informacionin universitar dhe në përmbajtjet mësimore, pavarësisht nga barriera fizike, ekonomike, kulturore apo sociale.

Ky mision mbështetet në parimet e arsimit si e drejtë themelore njerëzore dhe në bindjen se transformimi digjital duhet të përmirësojë, dhe jo të zëvendësojë, marrëdhënien njerëzore në procesin arsimor. Universiteti angazhohet të promovojë mësimdhënie inovative, kërkim të orientuar drejt zgjidhjeve reale të shoqërisë, dhe zhvillim profesional të stafit përmes përdorimit të teknologjive të hapura dhe bashkëpunimeve ndërinstitucionale.

Në këtë kuptim, misioni i UNKO-së është të ndërtojë një ekosistem digjital të barabartë dhe gjithëpërfshirës, ku mësimi, kërkimi dhe përvoja studentore të përforcohen nga teknologjia, por të udhëhiqen nga vlerat e humanizmit, bashkëpunimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

### Vizioni

Vizioni i Universitetit "Fan S. Noli" është të bëhet një qendër referimi për arsimin digjital gjithëpërfshirës në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit, ku teknologjia

përdoret në shërbim të njohurisë, të aksesit të barabartë dhe të krijimit të mundësive të reja për çdo student. Universiteti synon të ndërtojë një kulturë institucionale ku përfshirja, inovacioni dhe cilësia janë të ndërthurura në çdo aspekt të veprimtarisë akademike dhe administrative.

Ky vizion e vendos UNKO-n në një rrugë zhvillimi që lidh arsimin me transformimin shoqëror dhe ekonomik të rajonit juglindor të Shqipërisë, duke e bërë universitetin një faktor kyç në ndërtimin e komuniteteve të qëndrueshme dhe të arsimuara. Përmes investimeve graduale në teknologji, trajnimeve për staf dhe studentë, dhe forcimit të bashkëpunimeve ndërkombëtare, universiteti do të konsolidojë rolin e tij si institucion që udhëheq përfshirjen digjitale në arsimin e lartë publik.

Vizioni i këtij plani është që arsimi digjital në UNKO të mos jetë privilegj i pakicës, por realitet i përditshëm për të gjithë. Ai synon që çdo student, pavarësisht kushteve apo prejardhjes, të ketë mundësi të njëjta për të arritur sukses akademik, për të ndërtuar kompetenca profesionale dhe për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë përmes njohurive të fituara në një mjedis digjital gjithëpërfshirës.

**Vlerat themelore institucionale**

Zbatimi i këtij plani mbështetet mbi një sistem vlerash që përbën themelin e identitetit institucional të Universitetit "Fan S. Noli". Në qendër të tyre qëndron parimi i barazisë, i cili garanton që çdo individ të ketë mundësi të njëjta për të përfituar nga arsimi dhe teknologjia pa u penguar nga dallimet apo kufizimet personale. Aksesueshmëria shihet si një e drejtë që duhet të përshkojë çdo aspekt të jetës universitare, nga mësimdhënia dhe kërkimi deri te shërbimet administrative dhe komunikimi institucional.

Inovacioni është një tjetër shtyllë themelore që nxit përmirësimin e vazhdueshëm dhe orienton universitetin drejt përvetësimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor me ndikim shoqëror. Po aq e rëndësishme është edhe kultura e bashkëpunimit, e cila forcon lidhjet ndërmjet njësive akademike, stafit dhe studentëve, si dhe krijon ura partneriteti me institucione brenda dhe jashtë vendit.

Etika dhe përgjegjësia udhëheqin çdo vendimmarrje dhe garantojnë integritet në proceset akademike, duke e vendosur universitetin në shërbim të transparencës, të drejtësisë dhe të respektit për dinjitetin njerëzor. Në të njëjtën frymë, zhvillimi i qëndrueshëm përbën vlerën që lidh teknologjinë me kujdesin për burimet njerëzore dhe materiale, duke e orientuar universitetin drejt një modeli arsimor që ndërton të ardhmen pa komprometuar vlerat e së tashmes.

Këto vlera janë të pranishme në çdo veprim, politikë dhe strategji të universitetit, duke e bërë arsimin digjital gjithëpërfshirës jo vetëm një objektiv zhvillimi, por një kulturë institucionale që forcon identitetin, përgjegjësinë dhe vizionin e Universitetit "Fan S. Noli" për një të ardhme të arsimuar, të barabartë dhe të qëndrueshme.

## IV. PARIMET THEMELORE TË PLANIT STRATEGJIK

Parimet themelore që udhëheqin këtë plan përbëjnë boshtin e filozofisë institucionale të Universitetit "Fan S. Noli" në procesin e transformimit digjital gjithëpërfshirës. Ato përcaktojnë mënyrën se si universiteti koncepton, zbaton dhe vlerëson çdo nismë që lidhet me përfshirjen digjitale, duke siguruar që çdo vendim të mbështetet në drejtësi, efikasitet dhe qëndrueshmëri. Këto parime nuk janë thjesht deklarata orientuese, por përbëjnë standarde veprimi që ndikojnë në politikat institucionale, në praktikat akademike dhe në kulturën e brendshme të universitetit.

Së pari, barazia dhe aksesueshmëria janë parime themelore që garantojnë të drejtën e çdo studenti për të përfituar nga procesi mësimor pa pengesa digjitale apo fizike. Arsimi digjital nuk shihet si privilegj, por si e drejtë universale, që duhet të ofrohet në kushte të barabarta për të gjithë, pavarësisht gjinisë, moshës, aftësive apo origjinës sociale. Kjo nënkupton jo vetëm ofrimin e pajisjeve dhe platformave të përshtatshme, por edhe përshtatjen e përmbajtjeve dhe metodave të mësimdhënies për të garantuar akses efektiv.

Së dyti, gjithëpërfshirja institucionale nënkupton se përfshirja nuk është detyrë e një sektori të vetëm, por përgjegjësi e përbashkët e të gjitha strukturave të universitetit. Çdo njësi akademike dhe administrative duhet të reflektojë parimet e gjithëpërfshirjes në planifikimin e veprimtarive, në menaxhimin e burimeve dhe në mënyrën e ndërveprimit me studentët dhe stafin. Kjo qasje horizontale siguron që digjitalizimi të mos mbetet i kufizuar në teknologji, por të shndërrohet në kulturë organizative.

Një tjetër parim udhëheqës është përdorimi efikas i burimeve. Në një kontekst universitar publik me mjete të kufizuara financiare, zhvillimi digjital duhet të bazohet në planifikim racional, në identifikimin e burimeve të brendshme dhe në shfrytëzimin e mundësive që ofrojnë programet kombëtare dhe ndërkombëtare të bashkëpunimit. Kjo nënkupton orientimin drejt teknologjive me burim të hapur, partneriteteve afatgjata dhe zgjidhjeve të qëndrueshme që nuk ngarkojnë buxhetin institucional.

Qasja e bazuar në evidenca përbën një tjetër shtyllë të rëndësishme të këtij plani. Vendimmarrja dhe vlerësimi i progresit duhet të mbështeten në të dhëna të matshme, në analiza statistikore dhe në raporte periodike që pasqyrojnë gjendjen reale të aksesit dhe përdorimit të teknologjisë. Përdorimi i të dhënave ndihmon universitetin të përcaktojë prioritetet dhe të orientojë ndërhyrjet aty ku ndikimi është më i madh, duke shmangur praktikat sporadike apo vendimmarrjen pa bazë empirike.

Po aq thelbësor është edhe bashkëpunimi ndërsektorial, i cili forcon lidhjen midis strukturave të brendshme dhe partnerëve të jashtëm, përfshirë institucionet arsimore, komunitetin lokal dhe aktorët ndërkombëtarë. Përmes bashkëpunimit, universiteti mund të shkëmbejë përvoja, të ndajë praktika të mira dhe të përfitojë nga iniciativat që mbështesin zhvillimin e arsimit digjital dhe gjithëpërfshirës.

Së fundi, qëndrueshmëria përfaqëson garancinë afatgjatë të këtij plani. Çdo masë e propozuar synon të ketë ndikim të qëndrueshëm në kohë dhe të ndërtohet mbi kapacitetet ekzistuese të universitetit. Qëndrueshmëria nënkupton përdorim të

përgjegjshëm të burimeve, përkujdesje për mirëmbajtjen e infrastrukturës digjitale dhe investim të vazhdueshëm në formimin e stafit, në mënyrë që ndryshimet e nisura të mbeten funksionale dhe efektive në një horizont afatgjatë.

Nëpërmjet këtyre parimeve, Universiteti "Fan S. Noli" synon të garantojë që procesi i digjitalizimit të mos jetë një ndërhyrje e përkohshme, por një reformë e qëndrueshme institucionale që vendos përfshirjen dhe cilësinë në qendër të zhvillimit akademik.

## V. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Objektivat strategjikë përbëjnë boshtin veprues të këtij Plani për Arsimin Digjital Gjithëpërfshirës, duke përkthyer misionin, vizionin dhe parimet themelore në drejtime konkrete zhvillimi. Ata përcaktojnë prioritetet institucionale të Universitetit "Fan S. Noli" për periudhën 2026-2029 dhe synojnë ndërtimin e një mjedisi universitar ku teknologjia, përfshirja dhe cilësia bashkëjetojnë në mënyrë të qëndrueshme. Çdo objektiv përfshin një kuadër veprimesh të ndërthurura që prekin fushat e politikëbërjes, infrastrukturës, trajnimit, pjesëmarrjes studentore dhe mbështetjes digjitale, duke reflektuar realitetin e arsimit të lartë publik shqiptar dhe mundësitë reale të zhvillimit me mjete të kufizuara.

Nëpërmjet këtyre objektivave, universiteti synon të sigurojë jo vetëm transformim digjital teknik, por edhe transformim kulturor dhe institucional, që rrit aksesin, barazinë dhe ndjenjën e përkatësisë akademike në të gjitha nivelet e veprimtarisë universitare.

### Objektivi Strategjik 1: Integrimi i përfshirjes dhe aksesit digjital në politikat institucionale

Ky objektiv synon që përfshirja digjitale të bëhet pjesë e natyrshme e politikave të brendshme të universitetit. Zbatimi do të fillojë gjatë periudhës 2026–2028 përmes përfshirjes së elementeve të aksesit dhe gjithëpërfshirjes digjitale në aktet ekzistuese të UNKO, në vend të hartimit të një rregulloreje të re. Kjo qasje siguron përputhshmëri me strukturat aktuale dhe e bën procesin të qëndrueshëm e të zbatueshëm me burime të kufizuara. Zbatimi do të udhëhiqet nga Rektorati, në bashkëpunim me njësitë kryesore, Sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Qendrën e Karrierës dhe Alumni.

### Objektivi Strategjik 2: Integrimi i Dizajnit Universal për të Nxënë (UDL) në kurrikulat dhe mësimdhënie

Gjatë periudhës 2026-2028, universiteti do të zbatojë parimet e Dizajnit Universal për të Nxënë (UDL) në proceset e planifikimit kurrikular, mësimdhënie dhe vlerësim. Ky objektiv synon që çdo student të ketë mundësi të barabarta për të mësuar përmes formave fleksibile të prezantimit të përmbajtjes dhe vlerësimit të rezultateve. Zbatimi do të koordinohet nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe Qendrën e Ekselencës për Trajnimin e Mësuesve, me prioritet të mesëm dhe me synim për përfshirje graduale në të gjitha fakultetet.

**Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi dhe mbështetja e stafit dhe studentëve**

Në periudhën 2026-2029, universiteti do të përqendrohet në fuqizimin e kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve, mentorimit dhe zhvillimit profesional të stafit akademik e teknik, si dhe në përfshirjen aktive të studentëve në jetën digjitale të universitetit. Ky objektiv ka prioritet të lartë dhe do të udhëhiqet nga Sektori i Projekteve, Trajnimit Shkencor dhe Shërbimeve Terciare, në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe Këshillin Studentor. Qëllimi është krijimi i një mjedisi bashkëpunues që mbështet të nxënit e përbashkët dhe përmirësimin e përvojës akademike.

**Objektivi Strategjik 4: Pjesëmarrja aktive e studentëve dhe eliminimi i barrierave**

Ky objektiv, me afat 2026-2029 dhe prioritet të mesëm, synon forcimin e mekanizmave të pjesëmarrjes studentore në vendimmarrje dhe në proceset e përmirësimit të aksesit digjital. Ai përfshin përfshirjen e përfaqësuesve të studentëve në strukturat këshilluese dhe vendimmarrëse të universitetit, organizimin e forumeve dhe sondazheve për identifikimin e barrierave, si dhe zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese për barazinë digjitale. Aktorët kryesorë për zbatimin janë njësitë kryesore, Këshilli Studentor dhe Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA).

**Objektivi Strategjik 5: Mbështetja digjitale dhe qëndrueshmëria e sistemit**

Ky objektiv, i planifikuar për periudhën 2026-2029 dhe me prioritet të lartë, synon konsolidimin e infrastrukturës digjitale dhe garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të sistemeve teknologjike të universitetit. Zbatimi përfshin përmirësimin gradual të laboratorëve ekzistues përmes fondeve të projekteve Erasmus+ dhe donatorëve, si dhe përfshirjen e verifikimit të përditësimeve të pajisjeve dhe platformave digjitale në rishikimet periodike të sektorit IT. Aktorët përgjegjës janë Rektorati, njësitë kryesore, Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës, Sektori i Projekteve, Trajnimit Shkencor dhe Shërbimeve Terciare, si dhe Sektori i Prokurimeve dhe Investimeve.

Këta pesë objektiva përbëjnë kuadrin themelor të Planit Strategjik për Arsimin Digjital Gjithëpërfshirës të Universitetit "Fan S. Noli" dhe përfaqësojnë një angazhim institucional për zhvillim të qëndrueshëm, përfshirës dhe të matshëm. Ata synojnë të garantojnë që transformimi digjital të shoqërohet me drejtësi sociale, me përmirësim të cilësisë akademike dhe me forcimin e rolit publik të universitetit në shërbim të komunitetit rajonal dhe kombëtar.

## VI. MEKANIZMAT E ZBATIMIT DHE MONITORIMIT

Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin Digjital Gjithëpërfshirës mbështetet në një sistem të qartë mekanizmash institucionalë, që garantojnë lidhjen organike ndërmjet fazës strategjike dhe asaj operative të planit. Për secilin objektiv strategjik janë përcaktuar masa konkrete, afate kohore, përparësi dhe aktorë përgjegjës për

realizimin e tyre, në mënyrë që procesi të zhvillohet në mënyrë të koordinuar, të matshme dhe të qëndrueshme.

Tabelat që pasojnë përbëjnë instrumentin kryesor të zbatimit dhe monitorimit të planit. Ato përfshijnë për secilin objektiv përshkrimin e qëllimit, veprimet specifike që do të ndërmerren, afatin e realizimit, prioritetin e masave dhe strukturat përgjegjëse për ekzekutim, ndjekje dhe raportim. Kjo formë paraqitjeje e bën planin jo vetëm dokument orientues, por edhe mjet pune praktik për menaxhimin dhe vlerësimin e progresit në kuadër të arsimit digjital gjithëpërfshirës në Universitetin "Fan S. Noli".

Monitorimi i zbatimit do të kryhet periodikisht nga strukturat përgjegjëse të përcaktuara në plan, në bashkëpunim me Rektoratin, njësitë kryesore dhe sektorët përkatës. Ky proces do të bazohet në mbledhjen sistematike të të dhënave, në përgatitjen e raporteve për ecurinë e objektivave dhe në vlerësimin e rezultateve përmes treguesve të qartë matës.

Rezultatet e monitorimit do të shërbejnë për të rishikuar, përmirësuar dhe përshtatur veprimet në përputhje me zhvillimet e reja teknologjike, me nevojat e komunitetit universitar dhe me politikat kombëtare e evropiane në fushën e arsimit digjital.

Në këtë mënyrë, plani nuk mbetet një dokument statik, por një proces dinamik i cili evoluon nëpërmjet analizës, reflektimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet strukturave të universitetit dhe partnerëve të tij. Përmes këtyre mekanizmave, Universiteti "Fan S. Noli" synon të sigurojë që çdo hap drejt përfshirjes digjitale të jetë i matshëm, i qëndrueshëm dhe në përputhje me misionin e tij për një arsimin publik cilësor, të barabartë dhe inovativ.

| **Objektivi strategjik 1: Integrimi i përfshirjes dhe aksesit digjital në politikat institucionale** | |
|---|---|
| **Qëllim(et)** | - Të garantohet që çdo student i UNKO të ketë mundësi të barabarta për të ndjekur studimet, për të përfituar nga mjetet digjitale dhe për t'u përfshirë në jetën akademike, pa pengesa teknike apo sociale.<br>Garantimi i mundësive të barabarta për çdo student të UNKO përbën një shtyllë themelore të arsimit gjithëpërfshirës. Barazia në akses nuk kufizohet vetëm te prania fizike, por nënkupton pjesëmarrje të plotë në mësim, kërkim dhe jetën akademike. Duke përmirësuar përdorimin e platformave digjitale dhe formateve të aksesueshme, universiteti synon të eliminojë pengesat teknike apo sociale që shpesh pengojnë studentët me aftësi të kufizuara ose me kushte të vështira ekonomike. Një mjedis arsimor që respekton diversitetin kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin e një kulture akademike më të drejtë dhe në rritjen e cilësisë së përvojës studentore. |

| | |
|---|---|
| **Masa(t)** | ***Masa 1: Hartimi i rregullores institucionale për akses dhe përfshirje***<br>Kjo masë synon përfshirjen e parimeve të barazisë dhe aksesueshmërisë në aktet e brendshme të universitetit. Dokumenti do të përcaktojë detyrimet e çdo njësie akademike dhe administrative për të siguruar kushte të barabarta studimi dhe do të shërbejë si bazë ligjore për monitorim institucional.<br>***Masa 2: Përdorimi i platformave ekzistuese për materiale të aksesueshme***<br>UNKO do të përdorë Teams dhe Google Workspace për shpërndarjen e materialeve në formate alternative (tekst, audio, video me titra), pa kosto shtesë. Kjo masë bazohet në maksimizimin e përdorimit të mjeteve tashmë funksionale për t'u përshtatur me standardet e aksesueshmërisë (WCAG 2.1).<br>***Masa 3: Emërimi i Koordinatorëve të Aksesueshmërisë Digjitale***<br>Çdo fakultet do të ketë një koordinator përgjegjës për çështjet e aksesueshmërisë digjitale. Ai do të ndihmojë stafin akademik në formatimin e materialeve sipas udhëzimeve për përfshirje dhe do të raportojë periodikisht tek Rektorati për nevojat dhe pengesat e hasura.<br>***Masa 4: Vendosja e pikës së kontaktit për studentët me nevoja të veçanta***<br>Qendra e karrierës dhe alumni do të ketë një person përgjegjës për koordinimin e ndihmës akademike dhe teknike për studentët me aftësi të kufizuara. Ai do të bashkëpunojë me dekanatet dhe sektorin IT për të siguruar pajisje, përkthime ose përshtatje sipas nevojës.<br>***Masa 5: Përdorimi i burimeve të hapura për kontrollin e aksesueshmërisë***<br>Universiteti do të adoptojë mjete falas si WAVE dhe Colour Contrast Analyser për të testuar faqet e internetit dhe materialet digjitale. Kjo lejon që çdo njësi të verifikojë vetë cilësinë vizuale dhe teknike të materialeve, pa pasur nevojë për investime të reja softuerike. |
| **Afati kohor** | 2026-2028<br>Zbatimi do të fillojë me përfshirjen e elementeve për akses dhe gjithëpërfshirje në aktet ekzistuese të UNKO, si Statuti, rregulloret dhe udhëzimet e brendshme akademike (2026). Gjatë vitit 2027 do të realizohet emërimi i koordinatorëve të aksesueshmërisë në çdo fakultet, përshtatja graduale e materialeve digjitale sipas standardeve të aksesit dhe krijimi i një mekanizmi institucional për |

| | |
|---|---|
| | mbikëqyrjen e praktikave gjithëpërfshirëse. Deri në fund të vitit 2028 parashikohet vlerësimi i nivelit të zbatimit dhe përditësimi i akteve përkatëse, në përputhje me zhvillimet ligjore dhe teknologjike. |
| | E lartë |
| **Përparësia** | Barazia në akses është një parim themelor i arsimit të lartë publik dhe një tregues i cilësisë institucionale. Përfshirja e dispozitave për gjithëpërfshirje në aktet ekzistuese e forcon bazën ligjore të UNKO, duke shmangur krijimin e dokumenteve paralele dhe duke garantuar që çdo student të ketë mundësi të barabarta për pjesëmarrje në procesin akademik dhe në mjedisin digjital të universitetit. |
| **Aktorët që do të përfshihen** | - Rektorati: koordinon dhe mbikëqyr integrimin e dispozitave për akses dhe gjithëpërfshirje në aktet ekzistuese të universitetit.<br>- Njësitë akademike (fakultetet dhe departamentet): zbatojnë parimet e aksesit digjital në procesin mësimor dhe në dokumentacionin akademik.<br>- Sektori i Teknologjisë së Informacionit (IT) dhe Statistikave: siguron përshtatjen teknike të platformave dhe materialeve digjitale në përputhje me standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë (WCAG 2.1).<br>- Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA): ndihmon në mbledhjen e të dhënave dhe në evidentimin e pengesave që studentët ose ish-studentët kanë hasur gjatë përdorimit të shërbimeve digjitale dhe akademike, duke ofruar propozime për përmirësim. |

**Objektivi strategjik 2: Integrimi i Dizajnit Universal për të Nxënë (UDL) në kurrikulat dhe mësimdhënie**

| | |
|---|---|
| | - Të zbatohet gradualisht Dizajni Universal për të Nxënë në të gjitha lëndët dhe programet, duke përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe duke respektuar diversitetin e studentëve. |
| **Qëllim(et)** | Zbatimi gradual i Dizajnit Universal për të Nxënë synon që përfshirja të bëhet pjesë përbërëse e planifikimit akademik. Përmes përshtatjes së materialeve mësimore, larmishmërisë së mënyrave të prezantimit dhe vlerësimit, si dhe përdorimit të teknologjive falas, UNKO forcon ndjeshëm qasjen fleksibël ndaj të nxënit. Kjo qasje ndihmon pedagogët të adresojnë nevojat e ndryshme të studentëve pa pasur nevojë për investime shtesë, duke e bërë procesin mësimor më efektiv dhe të përshtatshëm për realitetin e arsimit të lartë publik shqiptar. UDL nxit përfshirje, motivim dhe përmirësim |

| | |
|---|---|
| | të cilësisë në të gjitha programet e studimit. |
| Masa(t) | ***Masa 1: Përgatitja e udhëzuesit praktik për UDL***<br>Një grup pune i përbërë nga pedagogë të Fakultetit të Edukimit dhe specialistë të Sektorit të projekteve, trajnimit shkencor dhe shërbimeve terciare do të hartojë një udhëzues të shkurtër praktik për përdorimin e UDL-së në planifikimin mësimor. Udhëzuesi do të përmbajë shembuj konkretë të përshtatjeve të lehta për lëndët ekzistuese.<br>***Masa 2: Trajnime të brendshme për stafin***<br>UNKO do të organizojë workshop-e praktike të drejtuara nga pedagogë që kanë marrë pjesë në projektin HAWKING ose në programe të ngjashme Erasmus+. Ky model "kolegu trajnon kolegun" shmang kostot e larta të trajnimeve të jashtme dhe nxit ndarjen e përvojës brenda institucionit.<br>***Masa 3: Krijimi i arkivës digjitale të materialeve të aksesueshme***<br>Në platformën Teams do të ngrihet një arkivë me materiale model (syllabuse, tekste, video, prezantime me titra). Ajo do të shërbejë si bazë referimi për mësimdhënësit që duan të përshtatin përmbajtjet e tyre, duke forcuar standardizimin institucional.<br>***Masa 4: Futja e UDL-së në procesin e akreditimit***<br>Në formularët e rishikimit të programeve të studimit do të shtohet një fushë për të vlerësuar nivelin e integrimit të UDL-së në kurrikula. Kjo do të mundësojë matjen e progresit në mënyrë të strukturuar dhe transparente. |
| Afati kohor | 2026-2028<br>Zbatimi do të zhvillohet në disa faza të ndërlidhura. Gjatë vitit 2026, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë do të integrojë parimet e UDL-së në proceset e rishikimit dhe miratimit të programeve të studimit. Në vitin 2027, njësitë kryesore do të përshtatin përmbajtjet mësimore dhe metodat e vlerësimit sipas parimeve të fleksibilitetit dhe aksesit digjital. Deri në fund të vitit 2028, Sektori i projekteve, trajnimit shkencor dhe shërbimeve terciare do të konsolidojë procesin përmes trajnimeve dhe shkëmbimeve të praktikave të mira ndërmjet stafit akademik. |
| Përparësia | E mesme<br>Integrimi i UDL-së kërkon zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe bashkërendim institucional. Edhe pse kërkon kohë për t'u zbatuar plotësisht, ndikimi i tij në cilësinë e mësimdhënies dhe përfshirjes së studentëve është afatgjatë dhe i qëndrueshëm. UDL i mundëson |

çdo pedagogu të planifikojë mësimdhënien në mënyrë të tillë që të përfshijë nevoja të ndryshme pa kërkuar burime shtesë, duke rritur efikasitetin dhe drejtësinë akademike.

**Aktorët që do të përfshihen**

- Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë: integron parimet e UDL-së në proceset e planifikimit, rishikimit dhe miratimit të programeve të studimit; përgatit udhëzuesit përkatës dhe siguron harmonizimin me standardet kombëtare të cilësisë.
- Njësitë akademike (fakultetet dhe departamentet): zbatojnë parimet e UDL-së në mësimdhënie dhe vlerësim, përshtasin materialet digjitale dhe ndajnë përvoja të mira me njëri-tjetrin.
- Sektori i projekteve, trajnimit shkencor dhe shërbimeve terciare: organizon trajnimet periodike për stafin akademik mbi dizajnin universal të të nxënit dhe mbështet zhvillimin profesional për zbatimin efektiv të parimeve gjithëpërfshirëse në kurrikulë dhe praktikë.

## Objektivi strategjik 3: Zhvillimi dhe mbështetja e stafit dhe studentëve

- Të përmirësohen njohuritë digjitale, pedagogjike dhe menaxheriale të stafit dhe studentëve për të garantuar një mjedis akademik që përdor teknologjinë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

**Qëllim(et)**

Përmirësimi i aftësive digjitale dhe pedagogjike të stafit dhe studentëve është parakusht për funksionimin e një universiteti modern dhe gjithëpërfshirës. Investimi në formim profesional përmes trajnimeve me burime të hapura, shkëmbimeve ndëruniversitare dhe praktikave "train-the-trainer" siguron një rritje të qëndrueshme të kapaciteteve pa barrë financiare shtesë. Studentët, nga ana tjetër, fitojnë aftësi të rëndësishme për mësimin vetëdrejtues dhe përdorimin e teknologjive ndihmëse. Kjo bashkëpunim ndërmjet stafit dhe studentëve krijon një kulturë mbështetjeje të ndërsjellë, ku dijet digjitale kthehen në mjet për barazi dhe pjesëmarrje aktive.

**Masa(t)**

***Masa 1: Trajnime vjetore me burime të hapura online***

Universiteti do të përdorë platforma falas (p.sh. EU Schoolnet Academy, Coursera for Campus) për trajnimet bazë mbi mësimdhënien digjitale dhe aksesueshmërinë. Kjo do të lejojë zhvillim profesional pa kosto buxhetore.

***Masa 2: Modeli "Train the Trainer"***

Një grup i vogël pedagogësh që trajnohen përmes projekteve ndërkombëtare (HAWKING, U2SID, etj.) do të shërbejnë si trajnerë

| | |
|---|---|
| | të brendshëm. Kjo siguron vazhdimësi dhe shkallëzim të njohurive brenda UNKO.<br>***Masa 3: Hartimi i manualit për teknologjitë ndihmëse***<br>Sektori IT, në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit, do të përgatisë një manual të shkurtër praktik që shpjegon përdorimin e lexuesve të ekranit, alt-teksteve, dhe mjeteve si NVDA apo Audacity. Ky material do të shpërndahet në formë digjitale.<br>***Masa 4: Mentoruesi digjital studentor***<br>Studentët me njohuri të mira teknologjike do të angazhohen si mentorë për bashkëstudentët me vështirësi në përdorimin e platformave. Programi do të njihet si praktikë vullnetare që mund të përfshihet në përfshirjen në aktivitete jashtëkurrikulare. |
| **Afati kohor** | 2026-2029<br>Zbatimi do të shtrihet në një periudhë katërvjeçare për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të kapaciteteve njerëzore. Gjatë vitit 2026 do të nisë hartimi i moduleve të trajnimit për aftësi digjitale dhe pedagogji gjithëpërfshirëse, ndërsa në vitet 2027-2028 do të zhvillohen cikle trajnimesh dhe aktivitete bashkëpunuese ndërmjet stafit dhe studentëve. Deri në fund të vitit 2029 parashikohet konsolidimi i një strukture të përhershme për zhvillimin profesional dhe përfshirja e praktikave të mentorimit studentor si pjesë e kulturës institucionale të UNKO. |
| **Përparësia** | E lartë<br>Forcimi i kapaciteteve njerëzore është thelbësor për qëndrueshmërinë e çdo strategjie digjitale dhe gjithëpërfshirëse. Investimi në trajnimin e stafit dhe fuqizimin e studentëve garanton përdorim më efikas të burimeve ekzistuese, rrit vetëbesimin profesional dhe përmirëson cilësinë e mësimdhënies dhe të shërbimeve universitare. Ky objektiv ndikon drejtpërdrejt në rritjen e standardeve akademike dhe në krijimin e një kulture bashkëpunuese e gjithëpërfshirëse brenda universitetit. |
| **Aktorët që do të përfshihen** | - Sektori i Projekteve, Trajnimit Shkencor dhe Shërbimeve Terciare: koordinon zhvillimin e moduleve të trajnimit, organizon veprimtari për përmirësimin profesional të stafit dhe siguron mbështetje për projektet që kontribuojnë në zhvillimin institucional.<br>- Njësitë kryesore (fakultetet dhe departamentet): identifikojnë nevojat për trajnime, përfshijnë rezultatet e tyre në planifikimin akademik dhe ndajnë praktika të mira ndërmjet stafit.<br>- Këshilli Studentor: nxit përfshirjen e studentëve në veprimtari bashkëpunuese, mentoring digjital dhe programe që lidhen me zhvillimin e kompetencave ndërpersonale e |

profesionale.

| Objektivi strategjik 4: Pjesëmarrja aktive e studentëve dhe eliminimi i barrierave | |
|---|---|
| | - Të forcohet roli i studentëve në përmirësimin e politikave të aksesit dhe të eliminohen pengesat strukturore e digjitale që kufizojnë përfshirjen. |
| **Qëllim(et)** | Përfshirja e studentëve në hartimin dhe zbatimin e politikave digjitale siguron që masat e ndërmarra të jenë të përshtatura me realitetin e tyre të përditshëm. Vlerësimi i pengesave përmes anketimeve dhe forumeve online ndihmon në identifikimin e sfidave të vërteta të aksesit dhe komunikimit, të cilat shpesh nuk janë të dukshme për administratën. Nxitja e pjesëmarrjes përmes komisioneve studentore dhe fushatave ndërgjegjësuese forcon ndjenjën e përgjegjësisë dhe përkatësisë. Një qasje e tillë bashkëpunuese e bën universitetin më transparent, më të ndjeshëm ndaj nevojave të studentëve dhe më afër modelit të një institucioni demokratik e gjithëpërfshirës. |
| **Masa(t)** | ***Masa 1: Krijimi i Grupit Studentor për Përfshirjen Digjitale***<br>Ky grup do të jetë pjesë e Këshillit Studentor dhe do të mbledhë periodikisht vërejtje nga studentët lidhur me vështirësitë në platforma, laboratorë apo komunikim digjital. Raportet e tij do t'i paraqiten Rektoratit çdo semestër.<br>***Masa 2: Anketime periodike mbi pengesat digjitale***<br>Qendra e karrierës dhe alumni do të realizojë çdo vit një pyetësor online për të identifikuar vështirësitë e studentëve në aksesin digjital. Rezultatet do të përdoren për përmirësime të synuara në platforma dhe shërbime.<br>***Masa 3: Përdorimi i kanaleve ekzistuese për raportim***<br>Në vend të zhvillimit të portaleve të reja, raportimi i vështirësive do të kryhet përmes e-mailit institucional dhe forumit të Teams. Kjo shmang kostot dhe garanton komunikim të drejtpërdrejtë me administratën.<br>***Masa 4: Fushata ndërgjegjësuese për barazinë digjitale***<br>Çdo vit akademik, UNKO do të organizojë një javë informuese për barazinë digjitale dhe të drejtat e studentëve me aftësi të kufizuara, me postera, leksione publike dhe pjesëmarrje të mediave lokale. |
| **Afati kohor** | 2026 – 2029<br>Procesi i zbatimit do të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme |

| | |
|---|---|
| | përgjatë katër viteve, duke nisur me përfshirjen e përfaqësuesve të studentëve në strukturat vendimmarrëse dhe këshilluese të universitetit (2026). Në periudhën 2027-2028 parashikohet konsolidimi i mekanizmave të pjesëmarrjes studentore, përfshirë anketimet periodike, forume të hapura dhe aktivitete ndërgjegjësuese mbi barazinë digjitale dhe gjithëpërfshirjen. Deri në fund të vitit 2029 synohet institucionalizimi i rolit të studentëve në proceset e politikëbërjes dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Karrierës dhe Alumni (QKA) dhe Këshillit Studentor për të ndërtuar ura më të qëndrueshme ndërmjet studimeve, tregut të punës dhe komunitetit universitar. |
| **Përparësia** | E mesme<br><br>Pjesëmarrja aktive e studentëve përbën një faktor kyç në përmirësimin e cilësisë institucionale dhe në krijimin e një universiteti që dëgjon, përshtatet dhe evoluon me nevojat e komunitetit të vet. Kjo përfshirje e organizuar ndihmon në identifikimin e pengesave reale në aksesin digjital, në promovimin e transparencës dhe në forcimin e ndjenjës së përkatësisë ndërmjet studentëve dhe stafit. Edhe pse kërkon kohë për t'u konsoliduar, ajo ka ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e klimës akademike dhe në zbatimin efektiv të parimeve të gjithëpërfshirjes. |
| **Aktorët që do të përfshihen** | - Njësitë akademike (fakultetet dhe departamentet): mbështesin pjesëmarrjen studentore në forume, komisione dhe aktivitete universitare që synojnë përmirësimin e kushteve akademike dhe digjitale.<br>- Këshilli Studentor: bashkëpunon ngushtë me strukturat akademike dhe administrative për evidentimin e barrierave që kufizojnë aksesin dhe pjesëmarrjen; ndërmerr nisma ndërgjegjësuese dhe projekte në nivel fakulteti apo universiteti.<br>- Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA): forcon lidhjet ndërmjet studentëve dhe institucioneve të punësimit, promovon programe trajnimi për aftësi digjitale dhe profesionale, dhe mbështet aktivitetet që rrisin përfshirjen sociale e profesionale të studentëve. |

## Objektivi strategjik 5: Mbështetja digjitale dhe qëndrueshmëria e sistemit

| | |
|---|---|
| **Qëllim(et)** | - Të ruhet dhe përmirësohet infrastruktura digjitale ekzistuese në mënyrë graduale dhe me burime të kufizuara, duke garantuar akses të barabartë dhe funksionalitet afatgjatë për të gjithë përdoruesit e universitetit. |

Zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës digjitale kërkon

menaxhim të kujdesshëm të burimeve ekzistuese dhe bashkëpunime afatgjata me partnerë vendorë e ndërkombëtarë. Përfshirja e kontrollit të përditësimeve në procesin periodik të rishikimit të sektorit IT siguron funksionalitet të vazhdueshëm pa shpenzime shtesë. Përdorimi i programeve me burim të hapur dhe rikthimi në përdorim i pajisjeve të dhuruara lehtëson barrën buxhetore dhe nxit kulturën e ripërdorimit. Në këtë mënyrë, universiteti ruan stabilitetin e sistemit digjital, rrit efikasitetin e punës dhe garanton që shërbimet akademike të mbeten të aksesueshme për të gjithë.

**Masa(t)**

***Masa 1: Modernizimi gradual i laboratorëve***

UNKO do të përmirësojë laboratorët ekzistues duke përdorur fonde nga projektet Erasmus+ dhe bashkëpunimet me donatorë vendorë. Përparësi do t'u jepet laboratorëve të fakulteteve që përgatisin mësues dhe atyre që ofrojnë formim praktik në teknologji, për shkak të ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së arsimit në rajon. Ndërhyrjet do të përfshijnë pajisje bazë kompjuterike, monitorë të përshtatshëm dhe akses në softuerë mësimorë falas.

***Masa 2: Përfshirja e verifikimit të pajisjeve dhe platformave digjitale në rishikimin periodik të sektorit IT***

Në rishikimin periodik që Sektori i Teknologjisë së Informacionit kryen për infrastrukturën e universitetit, do të përfshihet edhe verifikimi i përditësimit të pajisjeve kompjuterike dhe platformave digjitale të përdorura në mësimdhënie dhe administrim. Kjo qasje e integruar do të mundësojë identifikimin e hershëm të pajisjeve të amortizuara dhe versioneve të vjetruara të programeve, duke siguruar funksionalitet të qëndrueshëm dhe mbrojtje të të dhënave, pa pasur nevojë për fonde shtesë apo struktura të reja.

***Masa 3: Përdorimi i sistemeve me burim të hapur***

Për të reduktuar shpenzimet dhe për të rritur pavarësinë teknologjike, universiteti do të adoptojë programe falas me burim të hapur si LibreOffice, Moodle, Zotero dhe Audacity për mësim, kërkim dhe administrim. Këto programe janë plotësisht të përshtatshme me standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe mund të përdoren në çdo pajisje pa kosto licencimi, duke u bërë një alternativë e qëndrueshme për mjediset publike universitare.

***Masa 4: Bashkëpunim për donacione teknologjike***

Rektorati do të nxisë marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere, kompani teknologjike dhe organizata jofitimprurëse për dhurimin e pajisjeve të përdorura, të cilat mund të përmirësohen dhe ripërdoren në laboratorë ose për studentët në nevojë. Kjo praktikë do të ndihmojë në përditësimin gradual të pajisjeve dhe në

| | |
|---|---|
| | forcimin e lidhjeve me sektorin privat dhe rrjetet akademike rajonale. |
| **Afati kohor** | 2026-2029<br><br>Zbatimi do të zhvillohet në faza të koordinuara ndërmjet strukturave teknike dhe menaxheriale të universitetit. Në vitin 2026 do të fillojë përfshirja e verifikimit të përditësimit të pajisjeve dhe platformave digjitale në rishikimet periodike të infrastrukturës. Gjatë viteve 2027–2028, njësitë kryesore dhe Sektori i Projekteve do të punojnë në modernizimin e laboratorëve përmes fondeve Erasmus+ dhe donacioneve teknologjike, ndërsa Sektori i Prokurimeve dhe Investimeve do të garantojë mirëmbajtjen e qëndrueshme të pajisjeve dhe sistemeve ekzistuese. Deri në vitin 2029 parashikohet konsolidimi i sistemit të monitorimit të aksesueshmërisë dhe efikasitetit digjital në të gjitha shërbimet universitare. |
| **Përparësia** | E lartë<br><br>Qëndrueshmëria e sistemit digjital është një parakusht për funksionimin efektiv të mësimdhënies, kërkimit dhe administrimit universitar. Përmirësimi i infrastrukturës përmes planifikimit të integruar, përdorimit të burimeve me kosto të ulët dhe optimizimit të pajisjeve ekzistuese siguron një zhvillim gradual, të përballueshëm dhe të qëndrueshëm. Kjo qasje lejon që transformimi digjital të shoqërohet me menaxhim të mirëfilltë institucional dhe përputhshmëri me standardet bashkëkohore të arsimit të lartë. |
| **Aktorët që do të përfshihen** | - Rektorati: orienton prioritetet strategjike dhe mbikëqyr bashkërendimin ndërmjet njësive për zbatimin e planit të transformimit digjital.<br>- Njësitë akademike (fakultetet dhe departamentet): identifikojnë nevojat reale për pajisje, platforma dhe përmirësime teknike, duke kontribuar në planifikimin e modernizimit.<br>- Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës: përfshin në rishikimin periodik verifikimin e përditësimeve të pajisjeve dhe platformave digjitale; siguron përputhjen me standardet e aksesueshmërisë dhe mban evidencën statistikore të përdorimit.<br>- Sektori i Projekteve, Trajnimit Shkencor dhe Shërbimeve Terciare: kërkon dhe menaxhon fonde për investime në teknologji dhe modernizim të laboratorëve nëpërmjet projekteve kombëtare e ndërkombëtare.<br>- Sektori i Prokurimeve dhe Investimeve: planifikon dhe realizon procedurat për blerje, mirëmbajtje dhe rinovim të pajisjeve, duke siguruar që çdo investim të jetë në përputhje |

me objektivat strategjikë dhe me kapacitetet buxhetore të universitetit.

## VII. ANGAZHIMI PËR ZBATIM DHE PËRMIRËSIM TË VAZHDUESHËM

Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin Digjital Gjithëpërfshirës përfaqëson një proces të hapur dhe të qëndrueshëm, që kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet strukturave të universitetit dhe angazhim të plotë institucional. Ky plan nuk kufizohet në rolin e një dokumenti orientues, por përbën një kornizë veprimi që udhëheq transformimin digjital të Universitetit "Fan S. Noli", duke siguruar që çdo hap drejt modernizimit të shoqërohet me barazi në mundësi dhe përfshirje reale të të gjithë anëtarëve të komunitetit universitar.

Angazhimi për zbatim përfshin një proces të planifikuar, të monitoruar dhe të vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme. Çdo masë e parashikuar në plan do të ndiqet në përputhje me afatet dhe mekanizmat e përcaktuar në tabelat përkatëse, ndërsa raportimet periodike do të shërbejnë për të vlerësuar ecurinë dhe për të identifikuar nevojat për përmirësim. Ky proces do të sigurojë që masat të mos mbeten të izoluara, por të ndikojnë në mënyrë të ndërsjellë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit dhe shërbimeve universitare.

Përmirësimi i vazhdueshëm është pjesë përbërëse e këtij angazhimi. Ai do të mbështetet në analizën e të dhënave, në reflektimin institucional dhe në përfshirjen aktive të stafit dhe studentëve në vlerësimin e rezultateve. Përmes këtij procesi, universiteti do të jetë në gjendje të përshtasë politikat dhe praktikat e tij sipas zhvillimeve teknologjike, nevojave shoqërore dhe orientimeve kombëtare e evropiane për arsimin e lartë.

Në këtë frymë, Universiteti "Fan S. Noli" riafirmon përkushtimin e tij për të ndërtuar një mjedis digjital të qëndrueshëm, të hapur dhe gjithëpërfshirës, ku teknologjia shërben si mjet për zhvillim njerëzor dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë akademike. Ky angazhim përfaqëson jo vetëm një detyrim institucional, por edhe një vizion afatgjatë për një universitet që ecën në hap me ndryshimet e kohës, duke ruajtur vlerat e barazisë, etikës dhe shërbimit publik.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2426 prot                                                  Korçë, më 12 / 11 / 2025

**VENDIM**

**Nr. 669, datë 12. 11.2025**

**PËR**
**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT**
**"MASTER I SHKENCAVE"**
**NË**
**"TURIZMI SMART DHE ZHVILLIMI RAJONAL", 120 ECSTS**
**FAKULTETI EKONOMIK**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 38 pika dh, në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 18 pika 9, si dhe të Udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020 për "*Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë*", i ndryshuar të MASR, Senati Akademik, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit Marketing-Turizëm, Fakulteti i Ekonomisë, në mbledhjen e datës 12.11.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e njësisë bazë dhe të dekanatit të Ekonomisë, për hapjen e programit të përbashkët të studimit, "Master i Shkencave" në "Turizmi Smart dhe Zhvillimi Rajonal", për vitin akademik 2025-2026.
2. Grupi i punës dhe Drejtoria e Kurrikulave, ngarkohen me zbatimin e procedurave të aplikimit në portalin zyrtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2425 prot Korçë, më 12 / 11 / 2025

VENDIM

Nr. 668, datë 12.11.2025

PËR

MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATURË NË "TEKNOLOGJI TË AVANCUARA DHE ZBATIME TË INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË KËRKIMIN NDËRDISIPLINOR"

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërsië"*, neni 38 pika dh, në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 18 pika 9, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 *"Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë"*, i ndryshuar, të MASR, si dhe në propozimin e departamentit të Informatikës, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, për hapjen e programit të ri të studimit "Doktoratë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 12.11.2025,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e propozimit për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në "Teknologji të Avancuara dhe Zbatime të Inteligjencës Artificiale në Kërkimin Ndërdisiplinor", ofruar nga departamenti i Informatikës, për vitin akademik 2026-2027.
2. Grupi i punës dhe Drejtoria e Kurrikulave, ngarkohen me zbatimin e procedurave të aplikimit në portalin zyrtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2424 prot                                                                 Korçë, më 12 / 11 / 2025

**VENDIM**

**Nr. 667, datë 12.11.2025**

**PËR**
**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROJEKTET E KËRKIMIT SHKENCOR FINANCUAR NGA TË ARDHURAT E UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d), si dhe në Statutin e Universitetit, neni 18, pika 6, Senati Akademik në mbledhjen e datës 12.11.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Rregulloren për Projektet e Kërkimit Shkencor, financuar nga të ardhurat e Universitetit "Fan S. Noli", sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr.** 2103 **prot** **Korçë, më** 08 / 10 / **2025**

**VENDIM**

**Nr.** 574 **, datë** 08 . 10 **.2025**

**PËR**

**ZGJEDHJEN E ANËTARIT NË KOMISIONIN INSTITUCIONAL ZGJEDHOR, (PËRFAQËSUES TË STUDENTËVE)**

Në mbështetje të rregullores "*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UNIKO*", neni 6 pika 1, gërma a), Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.10.2025,

**VENDOSI:**

1. Të zgjedhë përfaqësues të studentëve në Komisionin Institucional Zgjedhor, znj. **Fjorela Bajraktari.**
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1972 prot                                                                 Korçë, më 29/ 09 / 2025

**VENDIM**

**Nr. 526, datë 29.09.2025**

**PËR**

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT NGA BACHELOR NË "MATEMATIKË-INFORMATIKË", NË "BACHELOR" NË "DATA SCIENCE", 180 ECTS**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërsië"*, neni 38 pika dh, neni 35 pika 9, në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 18 pika 9, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "*Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë"*, i ndryshuar, të MASR, si dhe në propozimin e departamentit të Matematikës dhe Fizikës, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane, për riorganizimin e programit të studimit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.09.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të studimit Bachelor në "Matematikë-Informatikë", në "Bachelor" në "Data Science", 180 ECTS, ofruar në tre vite akademike nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, Departamenti i Matematikës dhe Fizikës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr._1974_prot Korçë, më _29_/_09_/ 2025

**VENDIM**

**Nr._528_, datë _29_._09_.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E FORMËS TË DIPLOMËS SË GRADËS SHKENCORE "DOKTOR" NË "STUDIME GJUHËSORE DHE ETNOKULTURORE NË RAJONIN E BALLKANIT",**

**TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË**

Në zbatim të nenit 91, pikës 3 të Ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërsië*", nenit 70 pika 4, të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, në Udhëzimin e MASR nr. 11, datë 02.04.2020 "*Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës*" si edhe në udhëzimin e MASR nr.10, datë 30.3.2020 "*Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor*", i ndryshuar", Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.09.2025,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e formës të Diplomës së Gradës Shkencore "Doktor" në "Studime Gjuhësore dhe Etnokulturore në Rajonin e Ballkanit".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

Shëtitorja "Rilindasit", Tel. 082 242230, www.unkorce.edu.al, rektorati@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

# DIPLOMË DOKTORATE

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, i ndryshuar" si dhe në dokumentacionin e studimeve të kryera:

EMRI ATËSIA MBIEMRI

Lindur në ______________ më ___,___,____, regjistruar më ___,___,____, në studimet e doktoratës, në "STUDIME GJUHËSORE DHE ETNOKULTURORE NË RAJONIN E BALLKANIT"

referuar nivelit 8-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me kohë të plotë, me nr. matrikullimi ______, nr. rendor në Regjistrin Themeltar __________, pasi mbrojti disertacionin me temë:

______________________________________________________________

me Vendimin e Jurisë nr. ______datë __,__,____, i jepet

## DIPLOMË E GRADËS SHKENCORE

## "DOKTOR"

## NË "STUDIME GJUHËSORE DHE ETNOKULTURORE NË RAJONIN E BALLKANIT"

DEKANI

_______________

REKTORI

___________________

Nr. rendor i regjistrimit të Diplomës në Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave të IAL-së _____________
Nr. unik i formës së Diplomës Regjistrin Shtetëror të Diplomave __________________
Nr. në Regjistrin Shtetëror të Gradave Shkencore dhe Titujve Akademikë _______________
Nr. i matrikullimit të studimeve paraardhëse
Nr. i Diplomës të studimeve të ciklit paraardhës ___________
Lëshuar në ________, më __,__,____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

**Nr. 1522 prot** **Korçë, më 05/ 08 / 2025**

**VENDIM**

**Nr. 431, datë 05.08.2025**

**PËR**
**MIRATIMIN PARAPRAKISHT TË PROGRAMIT BUXHETOR VJETOR DHE AFATMESËM PËR PERIUDHËN 2026-2028**

Senati Akademik i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë i mbledhur në datën .08.2025, për miratimin e programit Buxhetor Vjetor dhe Afatmesëm 2026-2028, konform synimeve dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Arsmit dhe Strategjinë Kombëtare për zhvillim dhe integrim 2021-2026, mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH", të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", të ligjit "Për buxhetin e shtetit", të Udhëzimit "Për përgatitjen e programit buxhetor vjetor dhe afatmesëm" të Ministrisë së Financave, si dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 38 pika h,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë paraprakisht programin buxhetor vjetor dhe afatmesëm 2026-2028 konform synimeve dhe objektivave të përcaktuara në strategjinë e arsimit dhe strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2021-2026.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

Shëtitorja "Rilindasit", Tel. 082 242230, www.unkorce.edu.al, rektorati@yahoo.com

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr.1416 prot** **Korçë, më 07/07/2025**

**VENDIM**
**Nr.398, datë 07.07.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR ÇDO PROGRAM STUDIMI DHE TARIFAVE PËR REGJISTRIMIN PARAPRAK PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Mbështetur, në VKM nr. 288, datë 21.05.2018 për "*Miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë*", të ndryshuar, në VKM nr. 866, datë 23.10.2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.638, datë 22.07.2015, të Këshillit të Ministrave, "*Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016*", si dhe në VKM nr. 778, datë 26.12.2018, "*Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë*", të ndryshuar, pika 1 gërma a), Senati Akademik në mbledhjen online të datës 07.07.2025,

**VENDOSI:**

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e tarifave të shkollimit për vitin akademik 2025-2026 për programet e ciklit të parë, për programet e ciklit të dytë dhe programet profesionale të studimit.
2. T'i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e tarifave të regjistrimit paraprak 1,600 lekë për të gjitha programet e studimit Bachelor dhe programet profesionale, 2,500 lekë për të gjitha programet e studimit Master, dhe 3,000 lekë për program të dytë studimi.

3. Tarifa e regjistrimit për konkurrim në programin e studimit "Bachelor" në "Edukim fizik dhe sporte" do të jetë 5000 lekë/student.
4. Tarifa e rilëshimit të suplementit të diplomës do të jetë 1000 lekë/suplement diplome.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof.dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

| TARIFAT E STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emërtimi i programit të studimit | Lloji i programit (Bachelor/ Master Profesional/ Master i Shkencave, Program Profesional etj.) | Nr. kredite të programit të studimit | Tarifa vjetore e studimit | |
| | | | | Program i parë studimi | Program i dytë studimi |
| 1 | Gjuhë - Letërsi | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 35000 |
| 2 | Gjuhë - letërsi shqipe dhe gjuhë pakicash | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 35000 |
| 3 | Gjuhë dhe Kulturë Frënge | Bachelor | 180 ECTS | 15,000 | 15,000 |
| 4 | Gjuhë Angleze | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 5 | Mësuesi për Arsimin Fillor | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 6 | Mësuesi për Arsimin Parashkollor | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 7 | Edukim fizik dhe sporte | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 40,000 |
| 8 | Histori-Gjeografi | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 30,000 |
| 9 | Shkenca Politike | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 10 | Matematikë-Fizikë | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 11 | Matematikë-Informatikë | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 12 | Biologji- Kimi | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 13 | Inxhinieri Informatike | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 40,000 |
| 14 | Teknologji Informacioni | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 15 | Infermieri e përgjithshme | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 120,000 |
| 16 | Mami | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 100,000 |
| 17 | Administrim dhe Politika Sociale | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 18 | Financë - Kontabilitet | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 40,000 |
| 19 | Menaxhim | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 20 | Administrim Biznesi në Marketing | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 21 | Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 22 | *Teknologji Ushqimore | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 30,000 |
| 23 | Menaxhim Agrobiznesi | Bachelor | 180 ECTS | 15,000 | 25,000 |
| 24 | Inxhinieri Agronomike | Bachelor | 180 ECTS | 15,000 | 25,000 |
| 25 | Informatikë Biznesi | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 26 | Ekonomiks | Bachelor | 180 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 27 | Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 28 | Menaxhim Biznesi Bujqësor | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 29 | Teknika e prodhimit të farave dhe fidanëve | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 30 | Menaxhim veterinar | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 31 | Shërbim Social | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 32 | Mbështetës zyre për komunikimin, bibliotekë dhe arkivë | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 33 | Asistent Menaxher | Program Profesional 2- Vjeçar | 120 ECTS | 20,000 | 20,000 |
| 34 | *Mësuesi për Arsimin Special | Master Profesional | 120 ECTS | 60000 | 72000 |
| 35 | Mësues për Arsimin Fillor | Master Profesional | 120 ECTS | 60000 | 72000 |
| 36 | Sistemet Moderne të Telekomunikacionit dhe Teknologjitë e Internetit | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 37 | Infermieristikë | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 38 | Financë - Kontabilitet | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 39 | Marketing | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 40 | Menaxhim i turizmit atraksioneve dhe eventeve | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 41 | Administrim Biznesi | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 42 | Menaxhim i qëndrueshëm në agroturizëm | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 43 | Drejtim Agrobiznesi | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 44 | Administrim Publik | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 45 | Bankë dhe Sigurime | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 46 | Inxhinieri Agrare Profil Hortikulturë | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 47 | Cilësia dhe Siguria Ushqimore | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 48 | Marketingu Digjital | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 49 | Guidë Turistike | Master Profesional | 60 ECTS | 60000 | 72000 |
| 50 | Mësuesi për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 51 | Mësuesi në Gjuhën Angleze | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 52 | Mësuesi në Histori - Gjeografi | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 53 | Mësuesi në Shkencat Sociale | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 54 | Mësuesi në Matematikë-Fizikë | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 55 | Mësuesi në Biologji-Kimi | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 56 | Mësuesi në Edukim fizik, sport dhe shëndet | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 57 | Etika dhe Lidershipi | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 58 | Financë | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 59 | Kulturë, Media dhe Editim | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 60 | *Shkencat Bujqësore | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 61 | *Shkenca Kompjuterike | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 62 | Statistikë e Aplikuar | Master i Shkencave | 120 ECTS | 75000 | 90000 |
| 63 | Programi i studimit në formimin psokopedagogjik | Program i formimit të vazhduar | 35 ECTS | 35000 | - |

**** Shënim: Studentët përsëritës në programet e ciklit të dytë do të paguajnë të njëjtën tarifë për kredit, njësoj si studentët e rregullt.***
***Tarifa e regjistrimit paraprak 1600 lekë/student në programet Bachelor dhe Profesionale***
*Tarifa e regjistrimit paraprak 2500 lekë/student në programet e studimit Master*
*Tarifa e regjistrimit paraprak 3000 lekë/student në programet e dyta të studimit*
*Tarifa e regjistrimit për konkurrim në programin "Edukim Fizik dhe Sporte" do të jetë 5000 lekë/student*
***Tarifa e rilëshimit të suplementit të diplomës 1000 lekë/ suplement diplome***
**** Në rastin e njohjes së krediteve nga njësitë bazë studentët nuk paguajnë për kreditet e njohura në programet Master.***
**** Programe të reja në proces hapjeje/riorganizimi***
*Tarifa për kredit për program të parë Master Profesional 1000 lekë/ kredit*
*Tarifa për kredit për program të dytë Master Profesional 1200 lekë/ kredit*
*Tarifa për kredit për program të parë Master i Shkencave 1250 lekë/ kredit*
*Tarifa për kredit për program të dytë Master i Shkencave 1500 lekë/ kredit*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr.** 1346 **prot** **Korçë, më** 26 / 06 **/ 2025**

**VENDIM**

**Nr.** 380 **, datë** 26 **.** 06 **.2025**

**PËR**

**NGRITJEN E KOMISIONIT PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE "BACHELOR" NË "EDUKIM FIZIK DHE SPORTE", PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, nr. 80/2015, nenin 74, Udhëzimin nr.12, datë 30.06.2023 "*Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë*", në Urdhrin e përbashkët nr. 157, datë 03.06.2025 "*Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2025-2026*", si dhe në "*Rregulloren për zhvillimin e konkursit të pranimit në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte"*", Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.06.2025,

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e komisionit të konkursit të testit praktik të kandidatëve për programin e studimit "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte":
   - Doc. Marjela Burda
   - Msc. Nesti Binishi
   - Msc. Julian Shishi
   - Msc. Pandush Tasellari
   - Msc. Pavlina Evro
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit të konkursit përcaktohen në "Rregulloren për zhvillimin e konkurisit të pranimit në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr.** 1345 **prot** **Korçë, më** 26/ 06 / **2025**

**VENDIM**

**Nr.** 379 **, datë** 26.06 **.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E DATËS SË KONKURRIMIT, PËR PRANIMET NË PROGRAMIN E STUDIMIT "BACHELOR" NË "EDUKIM FIZIK DHE SPORTE"**

Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, nr. 80/2015, nenin 74, Udhëzimin nr.12, datë 30.06.2023 "*Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë*", në Urdhrin e përbashkët nr. 157, datë 03.06.2025 "*Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2025-2026*", si dhe në "*Rregulloren për zhvillimin e konkursit të pranimit në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte""*, Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.06.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë datën **18 gusht 2025**, si datë për zhvillimin e konkursit praktik për testet praktike të kandidatëve, për programin e studimit "Bachelor" në "Edukim Fizik dhe Sporte".
2. Sekretaria mësimore brenda datës **7 gusht 2025** afishon në mjediset e fakultetit listën e aplikantëve nga U-Albania dhe dokumentet për regjistrimin e kandidatëve në konkurs.
3. Datat e regjistrimit të aplikantëve për konkursin do të jenë **8-14 gusht 2025**.
4. Në datën **15 gusht 2025,** sekretaria mësimore shpall listën e aplikantëve të regjistruar për konkurrim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" - KORÇË

Shëtitorja "Rilindasit", Tel. 082 242230, www.unkorce.edu.al, rektorati@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1344 prot Korçë, më 26 / 06 / 2025

**VENDIM**

**Nr. 378, datë 26.06.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PLANET MËSIMORE PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma dh, si dhe në Statutin e Universitetit neni 18, pika 9, Senati Akademik pasi diskutoi propozimet e njësive kryesore për ndryshimet në planet mësimore, në mbledhjen e datës 26.06.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimet në planet mësimore të propozuara nga njësitë kryesore sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr. 1150 prot.** **Korçë, më 29.05.2025**

**VENDIM**

**Nr. 322, datë 29.05.2025**

**PËR**
**MIRATIMIN E KANDIDATËVE PËR REDAKTORË TË KOMISIONIT TË BOTIMEVE PËR "BULETININ SHKENCOR" TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 46 pika 3 (anëtarët e komisioneve të përhershme të institucionit), në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", neni 31 pika 4, (anëtarët e komisioneve të përhershme të universitetit), si dhe në Rregulloren e Buletinit Shkencor të Universitetit "Fan S. Noli", neni 3, pika 3 dhe 4, Senati Akademik pasi diskutoi dhe votoi për redaktorë të Komisionit të Botimeve për "Buletinin Shkencor" në mbledhjen e datës 29.05.2025,

**VENDOSI:**

1. Të zgjedhë redaktorët e Komisionit të Botimeve për "Buletinin Shkencor" të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, si më poshtë vijon:
   - Dr. Eneida Çifligu – Shkencat Bujqësore
   - Prof.as.dr. Eljona Tasho – Shkencat Matematike dhe Informatike
   - Dr. Arben Gjata – Shkencat Natyrore
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr. 1152 Prot.** **Korçë, më 29/ 05 / 2025**

**VENDIM**

**Nr. 324, datë 29.05.2025**

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË DOKUMENTEVE TË PRANIMIT TË PROGRAMIT TË KUALIFIKIMIT TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK LOKAL**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 81, VKM-në nr. 692, datë 5.10.2016, "Për miratimin e rregullores "kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre"", i ndryshuar, si dhe në UMTM nr. 258, datë 15.7.2024 "Për miratimin e rregullores për programet e kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë dhe procedurës për akreditimin e tyre", Senati Akademik pas miratimit të dekanatit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, në mbledhjen e datës 29.05.2025,

**VENDOSI:**

1. Të propozojë miratimin e kritereve dhe të dokumenteve të pranimit të programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik lokal:

1.1 – Kriteret e përgjithshme të pranimit ne programin e kualifikimit udhërrëfyes turistik lokal si më poshtë:
- të jetë mbi moshën 18 vjeç;
- të ketë mbaruar arsimin e mesëm ose arsimin e lartë
- të zotërojë një gjuhë ose gjuhët e huaja në të cilën udhërrëfyesi do të ushtrojë aktivitetin e tij

të mos ketë qenë i dënuar me heqje lirie për vepra penale të kryera me dashje;
Kritere specifike:
- Të kenë vendbanim në qarkun e Korçës (Korçë, Devoll, Maliq, Pustec, Kolonjë, Pogradec)

- Të kenë moshë 18-35 vjet

1.2 – Dokumentacioni që duhet të paraqitet pranë departamentit të Historisë dhe Gjeografisë:

- Diploma e mbarimit të arsimit të mesëm së bashku me listën e notave të noterizuar
- Dokumentin që vërteton njohjen dhe aftësitë komunikuese shumë të mira në gjuhën e huaj, në të cilën do të ofrojë shërbimet e tij udhërrëfyesi turistik. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj duhet të jetë të paktën i nivelit B2, sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët.
- Vërtetim që nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale
- Fotokopje të kartës së identitetit
- Fotografi për dokument të aplikuesit në format elektronik

2. Grupi i punës dhe Drejtoria e Kurrikulave ngarkohen me zbatimin e procedurave të mëtejshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr. 1151 prot** **Korçë, më 29 / 05 / 2025**

**VENDIM**

**Nr. 323, datë 29.05.2025**

**PËR MIRATIM TË MODELIT TË CERTIFIKATËS DHE SUPLEMENTIT TË PROGRAMIT TË KUALIFIKIMIT TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK LOKAL**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 81, VKM-në nr. 692, datë 5.10.2016, *"Për miratimin e rregullores "kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre""*, i ndryshuar, si dhe në UMTM nr. 258, datë 15.7.2024 *"Për miratimin e rregullores për programet e kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë dhe procedurës për akreditimin e tyre"*, Senati Akademik pas miratimit të dekanatit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, në mbledhjen e datës 29.05.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë modelin e certifikatës dhe suplementit të programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik lokal sipas modelit bashkëngjitur.
2. Grupi i punës dhe Drejtoria e Kurrikulave, ngarkohen me zbatimin e procedurave të mëtejshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" – KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

Nr. Regjistri: ____________

# CERTIFIKATË

Znj./Z. ______________________________

ka përfunduar programin e kualifikimit të

**UDHËRRËFYESIT TURISTIK** në kategorinë __________, për periudhën ____________________

dhe ka përfunduar __________ kredite të barazvlefshme me __________ orë.

**(Këto kredite nuk janë të transferueshme sipas sistemit ECTS)**

*Kjo certifikatë ofrohet në mbështetje të pikës 11 të nenit 5 të Urdhrit nr. 258, datë 15.07.2024 "Për miratimin e rregullores për programet e kualifikimit të Udhërrëfyesve turistikë dhe procedurës për akreditimin e tyre"*

**DEKANI** ..............................

**REKTORI** ..............................

## SUPLEMENTI I CERTIFIKATËS

Të dhëna identifikuese për mbajtësin e certifikatës

| | |
|---|---|
| Mbiemri/at / | Emri/at / |
| | |
| Datëlindja (dd.mm.vvvv) | Numri i regjistrit |
| | |

| Nr. | MODULET | KREDITE | ORË |
|---|---|---|---|
| 1. | Mjedisi Fizik dhe Natyra në Zonën e Veçantë | 20 | 10 orë leksion + 10 orë studim individual |
| 2. | Gjeografia Humane dhe Zhvillimi Shoqëror e Urban në Zonën e Veçantë | 20 | 10 orë leksion + 10 orë studim individual |
| 3. | Arkeologjia, Prehistoria dhe Antikiteti në Zonën e Veçantë | 20 | 10 orë leksion + 10 orë studim individual |
| 4. . | Historia e Përgjithshme e Zonës së Veçantë | 20 | 10 orë leksion + 10 orë studim individual |
| 5. | Diversiteti Kulturor i Zonës së Veçantë | 20 | 10 orë leksion + 10 orë studim individual |
| 6. | Arti & Arkitektura në Zonën e Veçantë | 20 | 10 orë leksion + 10 orë studim individual |
| 7. | Kohët Moderne | 20 | 10 orë leksion + 10 orë studim individual |
| 8. | Praktika dhe mësimi në terren | 20 | 10 praktikë në terren + 10 orë praktikë personale |
| 9. | Njohuri të përgjithshme për Shqipërinë | 6 | 6 orë leksion |
| 10. | Njohuri mbi teknikat e guidimit<br>1. Njohuri dhe Aftësi Profesionale të Udhërrëfyesit Turistik<br>Aftësi Biznesi dhe Kushtet e Punës<br>2. Ndihma e Shpejtë | 46 | 26 orë leksion + 20 orë studim individual |
| 11. | Praktikë | 108 | 70 orë praktikë në terren + 38 orë punë kërkimore |
| | **GJITHSEJ** | 320 | **102 teori, 90 autodidakt, 128 praktikë në terren** |

**Certifikimi i suplementit**

| | |
|---|---|
| Data (dd.mm.vvvv) | Firma |
| Në cilësinë e | Vula zyrtare |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

**Nr. 1149 prot** **Korçë, më 29 / 05 / 2025**

**VENDIM**

**Nr. 321, datë 29.05.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT AKADEMIK 2025-2026**

Mbështetur në urdhrin Nr. 145, datë 14.04.2025, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Për caktimin e datës së fillimit dhe mbarimit të vitit akademik 2025-2026, në institucionet e arsimit të lartë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.05.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë strukturën e vitit akademik 2025-2026, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof.dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" - KORÇË

# UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
# STRUKTURA E VITIT AKADEMIK 2025 – 2026

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tetor | | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | | | | SEMESTRI I PARË |
| | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Java 1 | 6 Tetor – 10 Tetor | | |
| | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | Java 2 | 13 Tetor – 17 Tetor | | |
| | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | Java 3 | 20 Tetor – 24 Tetor | | |
| | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | 1 | 2 | Java 4 | 27 Tetor – 31 Tetor | | |
| Nëntor | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | Java 5 | 3 Nëntor – 7 Nentor | **22 Nëntor** | |
| | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | Java 6 | 10 Nëntor – 14 Nëntor | Dita e Alfabetit | |
| | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | Java 7 | 17 Nëntor – 21 Nëntor | **28, 29 Nëntor** | |
| | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | Java 8 | 24 Nëntor – 28 Nëntor | Dita e Pavarësisë dhe Çlirimit | |
| Dhjetor | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | Java 9 | 1 Dhjetor – 5 Dhjetor | **8 Dhjetori** | |
| | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | Java 10 | 8 Dhjetor – 12 Dhjetor | Dita Kombëtare e Rinisë | |
| | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | Java 11 | 15 Dhjetor – 19 Dhjetor | | |
| | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | **Pushimet e Dimrit (22 Dhjetor - 4 Janar)** | | | |
| | 29 | 30 | 31 | 1 | 2 | 3 | 4 | **25 Dhjetor** Krishtlindja | | | |
| Janar | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | Java 12 | 5 Janar – 9 Janar | | |
| | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | Java 13 | 12 Janar – 16 Janar | | |
| | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | Java 14 | 19 Janar – 23 Janar | | |
| | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | 1 | Java 15 | 26 Janar – 30 Janar | | |
| Shkurt | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | **Sezoni i Dimrit: 2 Shkurt – 20 Shkurt** | | | |
| | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | (7, 8, 14, 15 Shkurt, jo datë provimi) | | | |
| | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | | | | |
| | 23 | 24 | 25 | 24 | 27 | 28 | 1 | Java 1 | 23 Shkurt – 27 Shkurt | | SEMESTRI I DYTË |
| Mars | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | Java 2 | 2 Mars – 6 Mars | | |
| | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | Java 3 | 9 Mars – 13 Mars | | |
| | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | Java 4 | 16 Mars – 20 Mars | **14 Mars** (Dita e Verës) | |
| | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | Java 5 | 23 Mars – 27 Mars | **20 Mars** (Fiter Bajrami) | |
| | 30 | 31 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | Java 6 | 30 Mars – 3 Prill | **22 Mars** (Sulltan Nevruz) | |
| Prill | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | Java 7 | 6 Prill – 10 Prill | **5 Prill** (Pashkët Katolike) | |
| | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | Java 8 | 13 Prill – 17 Prill | **12 Prill** (Pashkët Ortodokse) | |
| | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | Java 9 | 20 Prill – 24 Prill | | |
| | 27 | 28 | 29 | 30 | 1 | 2 | 3 | Java 10 | 27 Prill – 1 Maj | **1 Maj** (Dita e punëtorëve) | |
| Maj | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | Java 11 | 4 Maj – 8 Maj | | |
| | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | Java 12 | 11 Maj – 15 Maj | | |
| | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | Java 13 | 18 Maj – 22 Maj | | |
| | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | Java 14 | 25 Maj – 29 Maj | **27 Maj** (Kurban Bajrami) | |
| Qershor | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | Java 15 | 1 Qershor - 5 Qershor | | |
| | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | **Sezoni i Verës: 8 Qershor – 26 Qershor** | | | |
| | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | (13, 14, 20, 21 Qershor, jo datë provimi) | | | |
| | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | | | | |
| | 29 | 30 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | **Mbrojtja e Diplomës / Provimi i Formimit 3, 4 Korrik** | | | |
| Korrik | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | **Pushimet e Verës (7 Korrik - 30 Gusht)** | | | |
| | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | | | | |
| | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | | | | |
| | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | 1 | 2 | | | | |
| Gusht | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | | | | |
| | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | | | | |
| | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | | | | |
| | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | | | | |
| | 31 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | | | | |
| Shtator | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | **Sezoni i Vjeshtës 1 Shtator – 11 Shtator** | | | |
| | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | (**5 Shtator**, Shënjtërimi i Nënë Terezës, 7 Shtator jo datë provimi) | | | |
| | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | **Sezoni para Diplome 17, 18 Shtator** | | | |
| | 28 | 29 | 30 | | | | | **Mbrojtja e Diplomës / Provimi i Formimit 24, 25 Shtator** | | | |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr. 1153 Prot.** **Korçë, më 29/ 05 / 2025**

**VENDIM**

**Nr. 325, datë 29.05.2025**

# PËR MIRATIMIN E TARIFAVE DHE MËNYRËN E PAGESËS SË STAFIT TË PROGRAMIT TË KUALIFIKIMIT TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK LOKAL

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 81, VKM-në nr. 692, datë 5.10.2016, "Për miratimin e rregullores "kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre"", i ndryshuar, si dhe në UMTM nr. 258, datë 15.7.2024 "Për miratimin e rregullores për programet e kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë dhe procedurës për akreditimin e tyre", Senati Akademik pas miratimit të dekanatit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, në mbledhjen e datës 29.05.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë e tarifat dhe mënyrën e pagesës së stafit të programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik lokal
2. Tarifa e regjistrimit në program të jetë 1600 lekë;
3. Tarifa e plotë e programit të llogaritet 100 lekë/kredit, 32000 lekë total
4. Shpenzimet për pagesën e orëve mësimore dhe administrative do të mbulohen nga të ardhurat e krijuara nga aplikantët.
5. Të ardhurat e krijuara nga trajnimet do të shkojnë 30% për institucionin dhe 70% për pagesën e orëve mësimore dhe administrative të stafit të përfshirë.
6. Ky vendim t'i përcillet Bordit të Administrimit.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1154 prot. Korçë, më 29.05.2025

VENDIM
Nr. 326, datë 29.05.2025

PËR
MIRATIMIN E KANDIDATËVE PËR ANËTARË BORDI SHKENCOR TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË

Mbështetur në Rregulloren e Buletinit Shkencor të Universitetit "Fan S. Noli", neni 2 pika 2, Senati Akademik pasi votoi për anëtarët e Bordi Shkencor, në mbledhjen e datës 29.05.2025,

**VENDOSI:**

1. Të zgjedhë Prof.as.dr. Ilir Niçko, personel akademik me kohë të plotë, anëtar Bordi Shkencor të Buletinit Shkencor, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, përfaqësues i Fakultetit të Bujqësisë.
2. Të miratojë anëtarët e Bordit Shkencor të Buletinit Shkencor, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, profesorë të huaj dhe shqiptarë që nuk janë pjesë e Universitetit, pas propozimit të departamenteve, si më poshtë:
   - Associate Professor Mihaela Culea, PhD "Vasile Alecsandri University of Bacau" (Rumani)
   - Associate Professor Brindusa-Mariana Amalancei, "Vasile Alecsandri University of Bacau" (Rumani)
   - Eleni Grivas, "Universiteti i Kozanit"
   - Gentian Kostandini, "University of Georgia"
   - Genci Capi, "Universiteti i Tokios", Japoni
   - Julia Vullnetari, "Universitety of Southampton"
   - Mimoza Zografi Shpata
   - Fatbardh Sallaku, "Universiteti Bujqësor i Tiranës"
   - Artan Hoxha, "Universiteti i Tiranës"
   - Dhimitri Bello, "Universiteti i Tiranës"
   - Akli Fundo, "Universiteti Politeknik i Tiranës"
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr.** 951 **prot** **Korçë, më** 29 / 04 / **2025**

**VENDIM**

**Nr.** 254**, datë** 29.04**.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË KËSHILLIT STUDENTOR TË UNIVERSITETIT**

**"FAN S. NOLI", KORÇË**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 99, pika 6, si dhe në Statutin e Universitetit neni 80, pika 8, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 29.4.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Kërkesën e Këshillit Studentor të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë për miratimin e buxhetit për Këshillin Studentor, për vitin 2025, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 950 prot. Korçë, më 29.04.2025

**VENDIM**

**Nr. 253, datë 29.04.2025**

**PËR**
**MIRATIMIN E KANDIDATËVE PËR REDAKTORË TË KOMISIONIT TË BOTIMEVE PËR "BULETININ SHKENCOR" TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 46 pika 3 (anëtarët e komisioneve të përhershme të institucionit), në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", neni 31 pika 4, (anëtarët e komisioneve të përhershme të universitetit), si dhe në Rregulloren e Buletinit Shkencor të Universitetit "Fan S. Noli", neni 3, pika 3 dhe 4, Senati Akademik pasi diskutoi dhe votoi për redaktorë të Komisionit të Botimeve për "Buletinin Shkencor" në mbledhjen e datës 29.04.2025,

**VENDOSI:**

1. Të zgjedhë redaktorët e Komisionit të Botimeve për "Buletinin Shkencor" të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, si më poshtë vijon:
   - Dr. Klaudeta Merollari – Shkencat Ekonomike
   - Dr. Alma Karasaliu – Shkencat Filologjike
   - Dr. Evjonda Pylli – Shkencat e Edukimit
   - Dr. Suela Dinellari – Shkencat Humane
   - Dr. Zhinzela Qyli – Shkencat e Shëndetit Human
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr. 949 prot.** **Korçë, më 29.04.2025**

**VENDIM**

**Nr. 252, datë 29.04.2025**

**PËR**
**MIRATIMIN E KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË BORDIT SHKENCOR TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË**

Mbështetur në Rregulloren e Buletinit Shkencor të Universitetit "Fan S. Noli", neni 2 pika 2, Senati Akademik pasi diskutoi dhe votoi për anëtarë të Bordit Shkencor në mbledhjen e datës 29.04.2025,

**VENDOSI:**

1. Të zgjedhë anëtarët e Bordit Shkencor të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, si më poshtë vijon:
   - Prof.as.dr. Mirela Cini – Fakulteti Ekonomik
   - Prof.as.dr. Eris Rusi- Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë
   - Prof.as.dr. Magdalini Vampa – Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr.** 948 **prot** **Korçë, më** 29/ 04 / **2025**

# VENDIM

**Nr.** 251**, datë** 29.04**.2025**

## PËR MIRATIMIN E RREGULLOREVE TË DEPARTAMENTEVE TË FAKULTETIT TË EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË

Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d) si dhe në Statutin e Universitetit neni 18, pika 6, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 29.04.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Rregulloret e brendshme të Departamenteve, të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, si më poshtë:
   - Rregullore e Departamentit të Gjuhë-Letërsisë
   - Rregullore e Departamentit të Histori-Gjeografisë
   - Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja
   - Rregullore e Departamentit të Edukimit
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr.** 720 **prot** — **Korçë, më** 26 / 03 / **2025**

# VENDIM

**Nr.** 197 **, datë** 26 **.** 03 **.2025**

## PËR

## NDRYSHIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN E APELIMIT (PËRFAQËSUES I STUDENTËVE)

Në mbështetje të rregullores "*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UNIKO*", neni 40 pika 1, Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.03.2025,

**VENDOSI:**

1. Të ndryshohet si pëfaqësues i studentëve z. Kodhel Zere, në Komisionin e Apelimit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.
2. Të zgjedhë si përfaqësues të studentëve në Komisionin e Apelimit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, znj. Ina Bala, studente në programin e studimit "Informatikë Biznesi", viti i dytë, Bachelor, pranë Fakultetit Ekonomik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" – KORÇË

Shëtitorja "Rilindasit", Tel. 082 242230, www.unkorce.edu.al, rektorati@yahoo.com

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr. 719 prot** **Korçë, më 26 / 03 / 2025**

**VENDIM**

**Nr. 196, datë 26.03.2025**

**PËR**
**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT**
**"MASTER I SHKENCAVE"**
**NË**
**"SHKENCAT BUJQËSORE",**
**FAKULTETI I BUJQËSISË**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 38 pika dh, në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 18 pika 9, si dhe të Udhëzimit nr. 1 datë 14.01.2020 për "*Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë*", i ndryshuar të MASR, Senati Akademik, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Agronomisë, Fakulteti i Bujqësisë, në mbledhjen e datës 26.03.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e njësisë bazë dhe të dekanatit të Bujqësisë, për hapjen e programit të studimit, "Master i Shkencave" në "Shkencat Bujqësore", për vitin akademik 2025-2026.
2. Grupi i punës dhe Drejtoria e Kurrikulave, ngarkohen me zbatimin e procedurave të aplikimit në portalin zyrtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" – KORÇË

Shëtitorja "Rilindasit", Tel. 082 242230, www.unkorce.edu.al, rektorati@yahoo.com

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr.718 prot** **Korçë, më 26 / 03 / 2025**

**VENDIM**

**Nr.195, datë 26.03.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR REKRUTIMIN E PERSONELIT AKADEMIK DHE NDIHMËSAKADEMIK NË UNIVERSITETIN "FAN S. NOLI"**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d), si dhe në Statutin e Universitetit, neni 18, pika 6, Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.03.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Rregulloren për rekrutimin e personelit akademik dhe ndihmësakademik në Universitetin "Fan S. Noli", sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr. 717 prot** **Korçë, më 26 / 03 / 2025**

**VENDIM**

**Nr. 194, datë 26.03.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË BULETINIT SHKENCOR TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d), si dhe në Statutin e Universitetit, neni 18, pika 6, Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.03.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Rregulloren e Buletinit Shkencor të Universitetit "Fan S. Noli", sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 478 prot Korçë, më 17/ 02/ 2025

# VENDIM

**Nr. 131, datë 17.02.2025**

## PËR
## MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Mbështetur në Statutin e Universitetit neni 18, pika 26, si dhe bazuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018, (I ndryshuar) pika 2.7, gërma a, Senati Akademik pasi diskutoi për propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore në lidhje me kuotat e pranimit për vitin akademik 2025-2026, për të gjitha programet e studimit, në mbledhjen e datës 17.02.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kuotat e pranimit për të gjitha programet e studimit për vitin akademik 2025-2026, bazuar në propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore.
2. T'i përcjellë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit kuotat e miratuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 448 prot                                                                 Korçë, më 12/ 02/ 2025

**VENDIM**

**Nr. 125, datë 12.02.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT PËR TË GJITHA PROGRAMET STUDIMIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027**

Mbështetur në Statutin e Universitetit neni 18, pika 26, si dhe në shkresën e MAS, nr. 7955/1 prot, datë 19.12.2024, *"Për publikimin e kritereve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2026-2027"*, pasi diskutoi propozimet e departamenteve në lidhje me kriteret e pranimit në programet e studimit për vitin akademik 2026-2027, Senati Akademik në mbledhjen e datës 12.02.2025,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kritereve të pranimit për të gjitha programet e studimit për vitin akademik 2026-2027, sipas propozimeve përkatëse të departamenteve.
2. T'i përcjellë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit kriteret e miratuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" – KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr.__78__prot Korçë, më _13_/ _01_/ 2025

**VENDIM**

**Nr.__12__, datë _13_._01_.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PËRGJITHSHME DHE NUMRIN E PERSONELIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË, NË TË GJITHA NIVELET, PËR VITIN 2025**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 38, pika 1, gërma ç), të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 18, pika 5, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 27, datë 29.12.2017 *"Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë"*, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.01.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, në të gjitha nivelet, për vitin 2025, sipas materialit bashkëngjitur.
2. T'i propozojë për miratim Bordit të Administrimit, strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, në të gjitha nivelet, për vitin 2025.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof.dr. Lorenc Ekonomi**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr.** 82 **prot** **Korçë, më** 13 / 01 / **2025**

**VENDIM**

**Nr.** 16**, datë** 13.01**.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E MANUALIT TË CILËSISË TË UNIVERSITETIT**

**"FAN S. NOLI", KORÇË**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma j) si dhe në Statutin e Universitetit neni 18, pika 22, dhe neni 84 pika 3, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 13.1.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Manualin e Cilësisë së Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Manuali i miratuar me vendim nr. 300, datë 10.07.2020, të Senatit Akademik shfuqizohet.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 80 prot Korçë, më 13 / 01 / 2025

VENDIM

Nr. 14, datë 13.01.2025

PËR
DISA SHFUQIZIME NË RREGULLOREN E UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 38, pika 1, gërma d), të Statutit të Universitetit, neni 18, pika 6, si dhe Rregullores së Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 115, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.01.2025,

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të nenit 45 dhe pikën 3 të nenit 47 të Rregullores së Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 113, datë 30.03.2023.
2. Vendimi t'i përcillet të gjitha njësive përbërëse të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
REKTORI
Prof.dr. Lorenc Ekonomi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 79 prot                                        Korçë, më 13 / 01 / 2025

VENDIM

Nr. 13, datë 13.01.2025

PËR

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN MBI PROCEDURËN PËR APLIKIM, MIRATIM DHE ZBATIM TË PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA TË ARDHURAT E UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË**

Mbështetur, në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.05.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1 gërma d), si dhe në Statutin e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 18 pika 6, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.01.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin e nenit 5, pika 3, gërma ii) të "Rregullores mbi procedurën për aplikim, miratim dhe zbatim të projekteve të financuara nga të ardhurat e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë", miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 69, datë 22.02.2024, si më poshtë vijon:
   "Në zërat buxhetorë 2c, 2d, 2e nuk ka kufizime në % në lidhje me pjesën e mbetur të buxhetimit në zërat buxhetorë 2a dhe 2b".
2. Të miratojë ndryshimin e emërtimit të nenit 7, si më poshtë vijon:
   "Aplikimi, miratimi, zbatimi, përfundimi dhe dorëzimi"
3. Të miratojë ndryshimin e nenit 7, pika 5, gërma b) dhe c), të "Rregullores mbi procedurën për aplikim, miratim dhe zbatim të projekteve të financuara nga të ardhurat e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë", miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 69, datë 22.02.2024, si më poshtë vijon:
   b) Grupi/et kërkimor/e janë të detyruara të dorëzojnë raportin përfundimtar të realizimit të projektit jo më vonë se 2 (dy) javë pas përfundimit të projektit. Raporti përfundimtar dorëzohet pranë Drejtorisë së Projekteve dhe Kërkimit Shkencor. Në rast kur kjo drejtori nuk e miraton raportin, grupi i punës është i detyruar të bëjë korrigjimet dhe rregullimet sipas propozimeve.

Në rast se këto propozime nuk zbatohen, projekti quhet i dështuar dhe grupi i punës është i detyruar të kthejë të gjithë shumën e shpenzuar në kuadër të projektit.

c) Në ratet kur raporti përfundimtar miratohet, Drejtoria e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, në bashkëpunim me grupin e punës parashikon zbatimin e përhapjes së rezultateve. Në këtë fazë prezantohen qartë rezultatet e projektit, arritjet, mos-arritjet dhe arsyet, si dhe shpenzimet e bëra, sipas zërave të mëposhtëm: qëllimi dhe objektivat, metodologjia e projektit, ndryshimet e bëra në objektivat origjinalë (nëse ka të tilla), zbatimi i projektit, rezultateve, vlerësimi i tyre, rekomandime, përfitimet e institucionit, promovimi i rezultateve, menaxhimi i rreziqeve të shfaqura gjatë aplikimit, shpenzimet e buxhetit.

4. Vendimi t'i përcillet për miratim Bordit të Admisnitrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof. dr. Lorenc Ekonomi**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**
**SENATI AKADEMIK**

**Nr. 81 prot** **Korçë, më 13/ 01 / 2025**

**VENDIM**

**Nr. 15 , datë 13.01.2025**

**PËR**
**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E SEKTORIT TË STUDIMEVE DHE SEKTORIT TË TIK**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 38, pika 1, gërma d), si dhe të Statutit të Universitetit, neni 18, pika 6, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.01.2025,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 13, II, të nenit 10 të Rregullores së Sektorit të Studimeve dhe Sektorit të TIK, miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 113, datë 30.03.2023, si më poshtë vijon:
   *"Specialistët e sekretarisë së sistemit: Marrin nga specialistët e sekretarive mësimore rezultatet e ekuivalentimit të lëndëve sipas vendimeve të komisioneve të ekuivalentimit dhe i ngarkojnë ato në sistem për çdo student, deri në fund të muajit tetor."*
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**REKTORI**
**Prof.dr. Lorenc Ekonomi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" - KORÇË